

# **Stabiliteti Financiar – ndërtimi i kapaciteteve, besueshmërisë dhe sistemeve për një rregullativë efektive: roli i BQK-së**

Fjalim i z.Gani Gërguri

Guvernator, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK)

Prezantuar në Konferencën e parë ndërkombëtare mbi Raportimin Financiar në Kosovë, organizuar nga Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës (ShKCAK)

Hotel Emerald, Prishtinë, Kosovë

12 maj 2011

## **Hyrje**

Mirëdita të gjithëve.

Së pari, dua të përgëzojë asociacionin tuaj për ditëlindjen e 10-të, për kontributin tuaj enorm në ndërtimin e kapaciteteve të kontabilitetit dhe të auditimit në Kosovë.

Njëkohësisht dua t'ju falënderoj për ftesën tuaj e cila reflekton respektin që keni ndaj punës që po bën BQK-ja. Përndryshe, ne dy institucionet jemi partnerë që nga fillimi dhe BQK-ja si kujdestare e shfrytëzimit prudencial të granteve për ShKCAK-un është krenare të shoh këtë rritje tuajën imponante. Pastaj, ne jemi partnerë edhe për shkak se BQK-ja vazhdon të ketë rol të veçantë në çështje që kanë të bëjë me standardet e kontabilitetit dhe të auditimit për sektorin financiar.

Prezantimi im i sotëm është i fokusuar kryesisht në rolin dhe përgjegjësitë e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në ruajtjen e stabilitetit financiar në Kosovë.

## **Mandati i Bankës Qendrore**

Për shkak të specifikave individuale të vendeve, bankat qendrore në botë nuk kanë strukturë dhe objektiva tërësisht të njëjta. Disa banka qendrore karakterizohen me multiobjektiva (Rezerva Federale e SHBA-ve, Banka e Japonisë), ndërsa disa kanë vetëm një objektiv themelor (p.sh. Banka Qendrore Evropiane), etj.

Sidoqoftë, emërues i përbashkët në rrafshin global për një bankë qendrore moderne është se funksioni themelor i saj mbetet stabiliteti makroekonomik. Kjo për faktin se stabiliteti makroekonomik qëndron mbi dy shtylla kryesore të tij - *stabilitetin monetar* dhe *stabilitetin financiar*. Madje edhe në rastet kur stabiliteti financiar nuk është atashuar në mënyrë eksplicite tek banka qendrore, publiku i gjerë pret prej bankës qendrore që ta kryejë edhe

këtë detyrë. Kujtojeni angazhimet e Bankës së Anglisë, pastaj të FED-it rreth shpëtimit të disa nga bankave të tyre që u zhytën në vështirësi financiare.

Në rastin tonë, euroizimi ka siguruar stabilitetin monetar, kështu që BQK-së i është caktuar mbajtja e stabilitetit financiar si objektivi dhe detyrë parësore. Përndryshe, ky objektivi pas krizës së fundit globale financiare, me shpejtësi po kthehet nën ombrellën e shumicës së bankave qendrore në botë.

Në kontekst të titullit të këtij paneli më lejoni të ndalem shkurtimisht tek stabiliteti monetar, i cili njihet si parakusht jo vetëm për stabilitetin financiar, por edhe për vetë zhvillimin ekonomik të një vendi. Me këtë rast vetëm desha t'ju përkujtoj atë çka është nënvizuar nga të tjerët: përvoja e ekonomive të pazhvilluara na bën me dije se stabiliteti monetar kontribuon në zhvillimin ekonomik në mënyrë të theksuar vetëm nëse në të njëjtën kohë shoqërohet me përmirësim të theksuar të qeverisjes, të edukimit dhe të sistemit ligjor efikas dhe efektiv (të drejtat pronësore, zbatimi i kontratave komerciale, etj.).

### **Roli unik i BQK-së në mbajtjen e stabilitetit financiar**

Nëse e thjeshtojmë definicionin e stabilitetit financiar në suaza të implikimeve që ky objektivi ia faturon rolit të bankës qendrore, del se bankat qendrore kanë dy detyra kryesore ndërlidhur me objektivin e tyre mbi mbajtjen e stabilitetit financiar. Kjo ka të bëjë kryesisht me:

- *parandalimin e jo-stabilitetit financiar* në njërin anë; dhe
- *menaxhimin e pasojave të tregut financiar të paqëndrueshëm* në anën tjetër.

Në anën e *parandalimit të jo-stabilitetit financiar*, BQK-ja, praktikisht dhe ligjërisht është përgjegjëse për formulimin e duhur dhe të shëndoshë të rregullave dhe rregulloreve për sektorin financiar, pastaj është përgjegjëse për mbikëqyrje të institucioneve financiare si dhe për menaxhim të sistemit të pagesave në vendin tonë. Në këtë rrafsh, BQK-në e bën unik fakti se ajo është ndër bankat qendrore të rralla në botë që licencojnë, rregullojnë dhe mbikëqyrin jo vetëm bankat dhe sigurimet, por edhe çdo entitet tjetër që përfshihet në definicionin e institucionit financiar. Natyrisht se një aranzhman si ky i tipit “*all in one*” i kërkon BQK-së të investojë në ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve **shumëprofilëshe** për të garantuar një licencim, rregullativë dhe mbikëqyrje financiare efektive dhe efikase.

Përderisa në anën e *menaxhimit të pasojave të jo-stabilitetit*, shumica e bankave qendrore kanë një arsenal të tërë të instrumenteve siç janë huadhënësi i instancës së fundit, sporteli diskontues, rezervat e detyrueshme dhe politika e duhur e normës së kamatës, BQK-ja nga tërë këto aktualisht ka në dispozicion vetëm rezervën e detyrueshme.

Prandaj, në rrethana të këtilla, BQK-ja është e fokusuar kryekëput rreth **parandalimit të jostabilitetit financiar** dhe ajo e bën këtë duke shtuar në vazhdimësi si perimetrin ashtu edhe frekuencën e mbikëqyrjes së institucioneve financiare.

Kështu, krahas mbikëqyrjes mikroprudenciale (institucioneve individuale) BQK-ja po bën hapa inkurajues edhe në fushën e mbikëqyrjes makroprudenciale duke stress-testuar kështu qëndrueshmërinë e bankave individuale dhe atë të sistemit bankar si tërësi karshi skenarëve të mundshëm të burimeve të jo-stabilitetit financiar që mund të vijnë nga sektorë tjerë të ekonomisë. Për këtë qëllim, Indikatorët e Paralajmërimit të Hershëm janë standardizuar dhe në baza mujore u shpërndahen organeve vendimmarrëse të BQK-së. Të gjitha këto përpjekje janë sintetizuar në publikimin e Raportit të parë mbi Stabilitetin Financiar, i cili analizon kohezionin midis ecurive në sektorin financiar dhe atyre në ambientin e përgjithshëm.

Ndërtimi i kapaciteteve për të ndriçuar sa më thellë këtë kohezion është i domosdoshëm sidomos për nevojën e definimit të qartë të kushteve precize dhe të gjykimit sistemor në rast të përdorimit eventual të Rregullores (përndryshe ende në finalizim e sipër) për ndihmë për likuiditet në raste të jashtëzakonshme. Vetëm në rrethana të tilla një Rregullore e tillë do të jetë maksimalisht në funksion të parandalimit të jo-stabilitetit financiar, përkatësisht parandalimit të ashtuquajturit “hazard moral” dhe eliminimit të çfarëdo përqafimi të tepruar të rrezikut nga ana e menaxhmentit të bankave.

## **Korniza rregullative dhe kapacitetet mbikëqyrëse në funksion të stabilitetit financiar në Kosovë**

Korniza rregullative dhe mbikëqyrëse e BQK-së është zhvilluar kryesisht falë asistencës permanente të USAID-së, FMN-së dhe Bankës Botërore. E ndërtuar mbi standardet ndërkombëtare, kjo kornizë i mori parasysh që në fillim edhe specifikat kosovare gjë që rezultoi me një stabilitet dhe shëndetshmëri të sektorit financiar madje edhe gjatë kohës së krizës globale financiare.

Rregullat si ajo mbi raportin kredi/depozita, pastaj kufizimi në ekspozimet e jashtme, kërkesat për adekuatshmëri të kapitalit, për likuiditet, etj., dëshmuar të jenë instrumente mirë të definuara dhe të fuqishme në sigurimin e stabilitetit financiar në Kosovë (të dhënat e fundit mbi shëndetshmërinë e sektorit bankar ilustronjë këtë stabilitet:adekuatshmëria e kapitalit 18.1 përqind, mjetet likuide 35.3 përqind të gjithsej mjeteve, raporti kredi/depozita prej 78 përqind, kreditë jo-performuese 6.2 përqind, etj.).

Përkundër stabilitetit të cekur, BQK-ja në mënyrë proaktive vazhdon të testojë adekuatshmërinë e kursit të saj të patrullimit të sektorit financiar si dhe cilësisë së ambientit si përbrenda ashtu edhe jashtë sektorit financiar. Kështu, pas Vlerësimit të Pajtueshmërisë

me Parimet Bazë të Bazelit për Mbikëqyrje Bankare Efektive (*anglisht: Basel Core Principles Assessment for Effective Banking Supervision*), u identifikuan fusha që kërkojnë rifreskimin e kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse dhe mbi këtë bazë janë duke u rishikuar me prioritet rregullat si ajo për kapital, pastaj për rregulla për klasifikim dhe provizionim të kredive, për qeverisjen korporatave, rregullat e reja për sistemet e teknologjisë informative, etj.

Në bashkëpunim me FMN-në dhe me Thesarin amerikan është përgatitur drafti i Ligjit mbi bankat komerciale, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet tjera financiare jo-bankare, i cili adreson qartësisht disa nga temat më rëndësi si veprimet sanuese, pastaj forcimi i kërkesave për qeverisje korporatave, mbikëqyrja e konsoliduar (mbikëqyrja jo vetëm në relacionin amë-bijë, por edhe në relacionin bankë-njësi tjera të ndërlidhura të biznesit), eliminimi i paqartësive legjislative në lëmin e institucioneve mikrofinanciare dhe atyre jo-bankare, etj.

Në bashkëpunim me Bankën Botërore është finalizuar Ligji i ri mbi sistemin e pagesave i cili qartëson kriteret për operatorë dhe agjent tjerë të pagesave si dhe instalon funksionin e monitorimit të sistemeve të pagesave nga ana e BQK-së. Këtu vlen nënvizuar edhe projektet në proces si:

- Përgatitjet e përbashkëta me Thesarin (Ministrinë e Financave) për operacionalizimin e tregut të letrave me vlerë; dhe
- Implementimin e Strategjisë Kombëtare të Pagesave, me theks të veçantë në implementimin e RTGS-së (Shlyerjes Bruto në Kohë Reale) dhe të Planit të Vazhdimësisë së Punës – projekte këto kryesore në sigurimin e stabilitetit financiar.

Dhe, këtu nuk është fundi i rishikimit të kornizës rregullative. Përkundrazi, sektori financiar po hynë në një rëntgen gjithëpërfshirës:

- tashmë janë dakorduar për muajin qershor misionet e Bankës Botërore në ROSC (*anglisht: Report on the Observance of Standards and Codes*) për *Qeverisje korporative*, pastaj për *Josolvencën dhe Regjimet Kreditore/Debitore* në sektorin bankar, ndërsa sapo ka përfunduar ROSC në *Vlerësimin e Parimeve Bazë të Sigurimeve për mbikëqyrje efektive të kompanive të sigurimeve jetë dhe jo-jetë*. Programi i Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP) shumë i kërkuar edhe nga vendet e zhvilluara tashmë është planifikuar për kvartalin e dytë të 2012-së.

Rëntgeni në fjalë pritet që të:

- kalibrojë me përpikëri shëndetshmerinë e sektorit financiar (aftësia e mbikëqyrësve, e politikëbërësve dhe rrjeti i sigurisë financiare për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive tensionimit sistemor ) si dhe

- të vlerësojë aspektet zhvillimore të sektorit financiar me fokus të veçantë në ekzaminimin e cilësisë së kornizës rregullative dhe infrastrukturës financiare si dhe ekzaminimin e kontributit të sektorit financiar në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

Pritet që edhe një ekzaminim ekstra t'i bëhet çështjes së aksesit në shërbimet bankare dhe zhvillimit të tregut vendor të kapitalit – aspekte këto shumë me rëndësi posaçërisht për vendet më pak të zhvilluara dhe me të ardhura të ulëta.

Kornizat rregullative nuk rregullojnë vetvetiu. Madje, edhe kriza e fundit globale ka dëshmuar se një prej shkaqeve të saj ka qenë dështimi në qeverisjen rregullative. Rrjedhimisht, vetëm zhvillimi i profilit adekuat të burimeve njerëzore dhe të kapaciteteve tjera paraqet garancinë më të mirë se rregullativa adekuate do të dizajnohet dhe implementohet në favor të parandalimit të jo-stabilitetit financiar dhe rrjedhimisht në favor të zhvillimit dhe rritjes ekonomike.

Krahas rekrutimit, zhvillimit dhe mbajtjes së profilit kompetent dhe kredibil të personelit të BQK-së, padyshim se edhe ngritja e kapaciteteve si këto që i bën Shoqata e juaj si dhe ajo që paralelisht po zhvillohet për Regjistrin e kreditit, në katin e dytë mu në këtë hotel – udhëhequr nga USAID, do të rrisin raportimin financiar dhe me këtë transparencën në sektorin financiar. Kjo më tutje do kontribuojë në reduktimin e asimetrisë së informacionit në kredidhënie gjë që zvogëlon koston e kreditit dhe me këtë ndikon drejtpërdrejt në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

Ju faleminderit për vëmendje dhe punë të mbarë në këtë Konferencë!